



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

**PLK. D. nr. 649/23**

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT**, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Argjira Asllani, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatore e panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari V. S., për shkak të 9 vepra penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1, pika 1.1 lidhur me par 2 pika 2.7, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 4 muaj, aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.29/2015, i datës 05.06.2015, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.532/15, i datës 21.01.2016, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117 dhe 118 par. 4 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 12, 13, 14, 18, 22, 25 par.1 pika 1.2 dhe nenin 33 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me datë 07.12.2023, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** kërkesa për lirimin me kusht e të dënuarit V. S. nga i ati F., i lindur në M., me datë ..., me vendbanim në rr. "...", nr. ., F. K., shqiptar, shtetas i Republikë së Kosovës.

**II.** Kërkesa për lirimin me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 9 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, PKR.nr.29/2015, i datës 05.06.2015, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.nr.532/15, i datës 21.01.2016, V. S. është shpall fajtor për shkak të 9 vepra penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1, pika 1.1 lidhur me par 2 pika 2.7, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 4 muaj.

Me datë 30.10.2023, i dënuari e ka parashtruar kërkesën për lirim me kusht përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg, me arsyetimin se gjatë vuajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirim me kusht.

Paneli për lirim me kusht në seancën e mbajtur me datën 07.12.2023 pasi e shqyrtoi kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se:

**Kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar.**

Nga shkresat e çështjes, dosja e të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të 9 vepra penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par. 1, pika 1.1 lidhur me par 2 pika 2.7, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirim normal e ka me datë 08.07.2025 dhe nga llogaritja e dënimit rezulton se gjer më tani i ka vuajtur 1 vit, 8 muaj, 29 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 1 vit, 7 muaj, 1 ditë. Paneli gjatë shqyrtimit të dosjes i ka vlerësuar edhe raportet e tjerë të përpiluara nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, ku gjen se i dënuari ka treguar sjellje të mira, i angazhuar në punë dhe ka ndjekur programin rehabilitues. Lidhur me procesin e risocializimit sipas Ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese, deri më tani ka rrjedhur normalisht dhe pozitivisht.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, Paneli ka vlerësuar kushtet për lirim me kusht, të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, duke përfshirë kriteret e parashikuara në Rregulloren 01/39 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për lirim me kusht. Kriteret përfshijnë: peshën e krimit, historinë e kaluar kriminale, përshkrimin e personit të dënuar për krimin, qëndrimin ndaj viktimës, sjelljen gjatë burgimit, gjendjen psikiatrike dhe psikologjike, gjendjen fizike, historinë sociale, planet pas lirimit, pranimin e kontrollit dhe ndihmën nga Shërbimi Sprovues, ekzistencën e një rreziku të përgjithshëm për publikun, dhe perspektivën e një personi të dënuar me origjinë të huaj për të kthyer në shtëpi.

Paneli, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerësimit të gjitha kushteve dhe kriterëve si më lartë, konstatoi se procesi i risocializimit ende nuk është i plotë, duke marr parasysh peshën e veprave penale të kryera nga i dënuari, ngase peshë e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale dhe historinë e kaluar penale, andaj bazuar në këto konstatime, Paneli vlerëson se qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal, sipas dispozitave të nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është arritur, andaj kërkesa e personit të dënuar është refuzuar për një periudhë kohore prej 9 muajve dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Nga sa u tha më lartë, në zbatim të nenit 25 pika 1.2 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT**  
**PLK. D. nr. 649/23, datë 07.12.2023**

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 117 par. 16 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është e lejuar ankesa.